

TEPPEKI

PRODUKT PER MBROJTJEN E BIMEVE

TEPPEKI është insekticid i konceptuar për të mbrojtur kulturat bujqësore të sulmuara nga morrat e bimëve dhe krahëbardhat. Flonicamid është përbërës aktiv, i cili depërton shpejt në bimët e trajtuara. Ai ka një veprim translaminar, i cili ofron mbrojtje uniforme të bimës. Teppeki vepron kundër morrave të bimëve dhe insekteve të tjera thumbuese nëpërmjet kontaktit dhe nëpërmjet gëlltimit, duke ndaluar në mënyrë të menjëhershme furnizimin me ushqim, gjë e cila parandalon dëmet nga thumbimet. Teppeki i takon një klase kimike origjinale (klasa IRAC 9C), nuk ka ndër-rezistenca të njohura deri më tani me insekticide të tjera.

Lënda vepruese: 50% flonicamid
Formulimi: Granula të tretshme në ujë (WG)



KUJDES

Deklaratat e rrezikut dhe deklaratat parandaluese:

H319 Shkakton iritrim të syve.

P264 lajini duart, krahët dhe fytyrën pas kontaktit me produktin.

P280 Vishni doreza mbrojtëse/rroba mbrojtëse/mbrojtëse të syve/maske për fytyrë.

P305+P351+P338 Nëse ka kontakt me sytë: Pastrojeni me ujë për disa minuta. Largoni lentet nëse keni.

Vazhdoni larjen.

P337+P313 Nëse iritimi i syve nuk ndalon: kerkoni keshille/vemendje nga mjeku.

EUH208 Permban Disodium maleate (371-47-1). Mund të shkaktojë reaksion alergjik.

EUH401 Për të shmangur rrezikun për shëndetin dhe ambientin permbajuni instruksioneve për përdorim.

Masat parambrojtëse:

- Mbajeni në vende të sigurt dhe të paarrishme nga fëmijet.
- Ruajeni në vende të thata dhe të fresketa, larg ushqimeve dhe pijeve për njerezit si dhe ushqimeve për blegtorinë.
- Evitoni kontaktet e zgjatura të syve dhe lekures me preparatin.
- Evitoni marrjen e preparatit me organet e frymëmarrjes gjatë përgatitjes së solucionit sperkates dhe gjatë sperkatjes.
- Gjatë përdorimit të tij mos hani e mos pini lëngje dhe duhan.
- Gjatë punës përdor paisje mbrojtëse: kominoshe, doreza, maska, syze.
- Në perfundim të punës lani paisjet mbrojtëse, mjetet sperkatese, duart dhe pjesët e ekspozuara të trupit.
- Beni asgjësimin e ambalazhit sipas rregullave në fuqi.

Udhëzime për ndihmën e parë dhe këshilla për mjekun:

- Në rast kontakti me lëkurën, hiqni menjëherë rrobat e ndotura, lani lëkurën me ujë të bollshëm e sapun. Lani rrobat e ndotura para se ti rivishni.
- Në rast kontakti të preparatit me sytë, i lani ato me ujë të bollshëm për 10-15 minuta dhe kerkoni këshillë mjekësore.
- Në rast se merret me organet e frymëmarrjes, nxireni të aksidentuarin në vende të ajrosura.
- Në rast gëlltimit, jepini në mënyrë të përsëritur karbon aktiv dhe ujë të bollshëm. Çojeni të aksidentuarin në institucionin shëndetësor me të afërt dhe i tregoni mjekut etiketën e produktit.
- Antidot specifik nuk njihet. Mjekimi simptomatik.

Përdorimi:

Kultura	Dëmtuesi	Sasia (kg/ha)	Nr. Maks. i përdorimit	Karenca	Shënime
Agurmet	Morrat	0,1	2, me një interval prej 14 ditësh	60	Përdorim i autorizuar gjatë lulëzimit (vetëm një aplikim) dhe në periudhën e prodhimit të kullimit (vënie e parakohshme e produktit) jashtë pranisë së bletëve
Drithërat (i autorizuar vetëm mbi grurin)	Morrat	0,14	2, me një interval prej 21 ditësh	28	Përdorim i autorizuar në periudhën e prodhimit të kullimit (vënie e parakohshme e produktit) jashtë pranisë së bletëve
Qersh	Morri i zi i qershisë	0,14	2, me një interval prej 21 ditësh	28	Përdorim i autorizuar gjatë lulëzimit (vetëm një aplikim) dhe në periudhën e prodhimit të kullimit (vënie e parakohshme e produktit) jashtë pranisë së bletëve
Trangull (*), Trangull për turshi (*), kungulleshkë (*), pjepër, shalqi dhe kungull, domate, spec, etj.	Morrat e bimëve, krahëbardha	0,1	3, me një interval prej 14 ditësh	1	Përdorim i autorizuar në periudhën e prodhimit të kullimit (vënie e parakohshme e produktit) jashtë pranisë së bletëve
Kultura të ndryshme lulesh, trëndafili	Morrat, krahëbardha	0,14	3	-	Përdorim i autorizuar gjatë lulëzimit (vetëm një aplikim) dhe në periudhën e prodhimit të kullimit (vënie e parakohshme e produktit)

					jashtë pranisë së bletëve
Pemë dhe bimë dekorative	Morrat, krahëbardha	0,14	3	-	Përdorim i autorizuar në periudhën e prodhimit të kullimit (vënie e parakohshme e produktit) jashtë pranisë së bletëve
Kultura bimore për prodhim fare	Morrat, krahëbardha	0,14	2	-	Përdorim i autorizuar gjatë lulëzimit (vetëm një aplikim) dhe në periudhën e prodhimit të kullimit (vënie e parakohshme e produktit) jashtë pranisë së bletëve

(*) Lejohet vetëm për të lashtat e mbrojtura.

(**) Mos të kalojë 3 aplikimet e Teppeki-t për ciklin e të lashtave për të gjitha dëmtuesit e bimëve. Te domatet, deri në 3 aplikimet me një interval në mes prej 14 ditësh të flonicamid për cikël, pavarësisht nga dëmtuesit apo lloji i aplikimit.

(***) Afati para korrijës përcaktohet nga faza e të lashtave.

Për të gjitha kulturat bimore, trajtimi i parë kundër morrave të bimëve (ose insekteve të tjera thumbues) duhet të kryhet kur sistemet e paralajmërimit parashikojnë një infektim të madh me morra të bimëve, ose kur caku i dëmit është arritur.

Aplikim me ujë pika-pika në domate, patëllxhanë:

- Në rast aplikimi pika-pika: Aplikoni Teppeki në mënyrë të hershme pas mbjelljes (trapiantimin bimëve deri në 2 apo 3 javë pas transplantimit).
- Përsëriteni aplikimin (nëse është e nevojshme) brenda 2 javësh.
- Në rast të dy aplikimeve të njëpasnjëshme pika-pika kundër krahëbardhës, një aplikim i tretë në gjethe me Teppeki kundër morrave të bimëve është i mundur me kusht që ky të jetë i paraprirë nga një tjetër produkt me veprim të ndryshëm. Efikasiteti i preparatit mund të jetë i mesëm ndoshta dhe i dobët kundër morrave të bimëve në rritje të ndjeshme tek kultura e domates dhe patëllxhani.

Përgatitja e spërkatjes

Mbushni 50 % të vëllimit të kërkuar të rezervuarit me ujë të pastër. Filloni inkorporimin duke shtuar gradualisht produktin dhe duke përzier në të njëjtën kohë. Së fundi shtoni sasinë e mbetur të ujit të kërkuar. Shpërlani enën e zbrazët tri herë dhe shtojeni në pjesën tjetër të produktit të holluar. Mbajeni spërkatësen në gjendje të tundur deri në fund të spërkatjes.

Vëllimi i spërkatës

Pemët frutore: është e nevojshme që të përshtatet sasia e ujit varësisht nga përmasat e pemës, niveli i zhvillimit të saj, si dhe me llojin e spërkatës. Për një pemishte standarde duhet llogaritur deri në 1000 lit/ha ujë. Kultura të tjera: vëllimi minimal i ujit i rekomanduar është 150 lit/ha.

Selektiviteti

Doza dhe kushtet e përdorimit të këshilluara të Teppeki-t nuk kanë efekte negative mbi të lashtat dhe pemët frutore.

Përzierjet

Do të ishte e udhës që të bëhet një provë e përputhshmërisë, duke bërë një spërkatje mbi një sipërfaqe të konsiderueshme të të lashtave.

Administrimi i rrezikut e rezistencës.

Përdorimi i përsëritur i preparateve që përmbajnë substanca aktive të të njëjtës familje kimike ose me të njëjtën mënyrë veprimi, mund të çojë në shfaqjen e organizmave rezistente. Për të ulur këtë rrezik, është e këshillueshme të alternoni ose të kombinoni ato.

Verejtje per perdorimin:

Drithëra (grurë). Teppeki është përdorur nga faza gjethi i fundit deri në fazën kokërr e bardhë. Përdorimi i parakohshëm ka efekt edhe në morrat e gjetheve.

Patate për konsum të përditshëm dhe industrial. Teppeki përdoret nga faza e ngritjes deri në fazën e pjekjes së patates.

Patate per fare. Dy aplikime të njëpasnjëshme në programin e mbrojtjes kundër morrave të bimëve janë të rekomanduara. Është e nevojshme të përfshihen aplikime të vajrave minerale (të kombinuara ose jo me Teppeki) për të luftuar kundër transmetimit të viruseve jo perzistente.

Pemë frutore dhe agrume. Aplikimi para ose pas lulëzimit. Kur aplikohet pas lulëzimit, bëni trajtimin para mbështjelljes së parë të gjetheve.

Kulturat bimore në fara. Përdorimi në farëmbajtës i panxharit nuk është i lejuar.

Fitotoksiciteti:

Nuk është fitotoksik kur përdoret në kulturat e mesiperme dhe sipas dozave të rekomanduara.

Ndikimi në ekosistem:

Për të mbrojtur organizmat ujorë, respektoni një zonë të pa trajtuar prej 5 metra nga pikat e ujit. Mos e përdorni në prani të bletëve.

Shënim: Përdorim i autorizuar gjatë lulëzimit (bletët) afati i izolimit: 6 orë në fushë dhe 8 orë në serrë. Respektoni udhëzimet për përdorim që të shmagni rreziqet për njeriun dhe mjedisin.

I dëmshëm për organizmat ujorë: mund të shkaktojë efekte afatgjata në mjedisin ujor. Ky material dhe ambalazhet duhet të eliminohen në mënyrë të sigurtë.

Mos ndotni ujërat me produktin ose ambalazhet e tij. Mos pastroni pajisjet spërkatëse pranë ujërave sipërfaqësorë. Evitoni ndotjen nëpërmjet rrjedhjes.

Karenca:

Shih të dhënat e tabelës së përdorimit.

Magaznimi:

Ruajeni në ambalazhin origjinal, në vende të thata të ajrosura e të pa ekspozuara nga drita direkte e diellit.

Nr dhe data e regjistrimit: 581, date 17.09.2014.

Sasia neto e PMB-se, që ndodhet në ambalazhin baze: deri 2 kg.

Data e prodhimit ;

Data e skadencës ose periudha e ruajtjes (sipas kërkesëve të përcaktuara): 3 vjet; Numri i partise së mallit (serise) ose shenja të tjera identifikuese ;

Tipi i ambalazhit baze: shishe plastike HDPE.

Emri dhe adresa e Aplikantit: ISK Biosciences Europe N.V. Adresa: Diegem, Belgjikë.

Emri dhe adresa e fabrikuesit të PMB-se: ISK Biosciences Europe N.V. Adresa: Diegem, Belgjikë. Emri dhe adresa e ambalazhuesit (kur ambalazhi kryhet në Republikën e Shqipërisë):

